



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

umri i lëndës: 2018:041987

Datë: 12.12.2019

Numri i dokumentit: 00713403

**P.nr.980/2014**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari Adem Shabani, me procesmbajtësen Erza Shamolli, në çështjen penale kundër të pandehurit I.B, nga fsh....., Komuna Ferizaj tani me vendbanim në rrugën ..., nr.... në Lipjan i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.851-1/14 të dt.16.09.2014, për shkak të veprës penale ”vjedhja e shërbimeve komuna” nga neni 320 par.1 të KPRK-së, por në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbështetur në nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-së Nr.06/L-074 e rikfalifikon në kryerjen e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së, pas shqyrtimin gjyqësor, në prani të prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit I.B, përfaqësuesin e të dëmtuarës KEDS-it në Ferizaj, A.J me datën 11.12.2019, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari I.B, me vendbanim në Lipjan rruga ... nr....., i lindur me ..., nga i ati R... dhe e ëma N..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion gurëthyes, i martuar, babë i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri, me numër personal ....-

**ËSHTË FAJTORË**

Sepse me datën 13.2013,në lokalit e tij në fsh....., Komuna Ferizaj, gjatë kontrollit nga ana e punëtorëve të KDS-it, Distrikti në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, të shërbimit komunal për vete, në atë mënyrë që konsumatori është furnizuar me energji elektrike nëpërmes një kabloje duke anashkaluar pikën matëse ku si pasojë energjia elektrike far nuk është regjistruar, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in –Distrikti në Ferizaj, në shumë prej 1,089, Euro,-

Me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 81 dhe 82 të KPRK-së (Kodi Penal Nr.06/L-074 dhe ) neneve 498, 499 të KPPK-së, të akuzuarit **I.B** i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

- Me Vërejtje gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

- Qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që ti jepet kryesit qortim, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën penale, që i vihet në barrë dhe në rastin konkret, vërejtjes gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

- Përfaqësuesin e të dëmtuarës KEDS-in Distrikti në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

- Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, komfor nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbartimit të dhunshëm

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr.851-1/14 të dt.16.09.2014, kundër të akuzuarit I.B, „nga fshati ..., Komjuna Ferizaj tani me vendbanim në Lipjan rruga ... nr...., për shkak të veprës penale ”vjedhja e shërbimeve komuna” nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt. 11.12.2019, në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së e beje rikfiakimin e veprës penale nga vepra penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-se në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, meqenëse dënimi është me i favorshëm. Pas administrimit të provave në këtë shqyrtim gjyqësor e sidomos në dëgjimin dëshmitareve F.O, provave materiale të propozuara në aktakuzë, konsiderojmë se u vërtetua gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuzë i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptoj një dënim të parapara me ligj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës A.J në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare deklaroi se mbështesim fjalën e prokurorit të shtetit, dhe mbesin pranë kërkesës së precizuar për dënim që i'u është shkaktuar të dëmtuarës si në dispozitiv të aktakuzë dhe për këtë i ofron dëshmi gjykatës me shkrim që ti bashkëngjitet shkresave të kësaj lënde penale transaksionet e

konsumatorit-Ekstraktin nga librat Afariste DFE-90394331 emri i lokalit I.R.B ,Adersa ... e dt.26.11.2019.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tersi e mbështet mbrojtjen e tij që ka dhen sot në shqyrtimin gjyqësor dhe nuk e ndien vetën të fajshëm për veprën penale që akuzohet i propozon gjykatës që në mungesë të provave ta shpallë të pa fajshëm.

Pasi i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1.të KPPK-së, fton prokurorin e shtetit, përfaqësuesin e të dëmtuarës KEDS-in-Distrikti bë Ferizaj dhe të pandehurin që të paraqesin fjalën hyrëse për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tyre.

Konform nenit 329 gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruara të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

Dëshmitari F.O, punon në KEDS-Distrikti në Ferizaj në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 10.12.2019 dhe vazhduar me datën 11.12.2019 në marrjen në pyetje nga prokurori i shtetit ka deklarua se është e vërtet se që në vitin 2013, punon në KEDS-Distrikti në Ferizaj dhe atë në shërbimin e kontrollës dhe lidhjeve të konsumatorëve në rrjetin elektrik, ku në bazë të detyrës shkoj te konsumatori dhe bëjë verifikimin e njehsorit elektrik se a është i bllobuar a është në gjendje të rregullt, dhe shikoj mos është kyçur jashtë pikës matëse ndonjë kablo duke anashkaluar pikën matëse në njehsorin elektrik dhe mbaj edhe numrin e ID që e kam ..., nuk e kontestoj se ka nënshkrua procesverbalin me numër 07105456 i datës 13.12.2013 por kamë edhe procesverbalin i të njëjtës datë që kamë qenë te konsumatori për të pranuar instalimin elektrik ku kemi cekur se lokali i konsumatorit I.B, i plotëson kushtet që të regjistrohet si konsumator i Ri ku në shqyrtimin gjyqësor i dorëzoj gjykatës.

Pas dëgjimit të dëshmitarit F.O, punëtorë i KEDS-it-Distrikti në Ferizaj, në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor janë lexuar provat të propozuar në aktin akuzues: procesverbali me nr.0710546 , të datës 13.12.2013; fatura nr.408770 e dt.31.12.1013.

I pandehuri I.B në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjen e dhënë ka deklaruar se në vitin 2013, ka blerë një pronë-pjesën e gurëthyesit nga shitësi XH.B, ku jemi marrë vesh që makinat e punës të zhvendosen në pronën time dhe pajiset teknike të kyçen në rrjetë. Kur kamë përgatitur dokumentacioni që të kyçem në rrjet në mënyrë legale blerësi nuk e ka lejuar, po për këtë kamë njoftuar policinë, dhe policia pas njoftimit kanë ardhur në ven të ngjarjes dhe të njëjtit na u kanë lutur që të mos inicioj rast për mos me e dëmtuar shitësin, ku nëse ai lejon me u kyçur të jen prezent dhe policia ajo ka ndodhë kjo është arsyeja, dhe për tu furnizuar pasjet me energji elektrike. Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri deklaroi se nuk kishin bërë kërkesë për ta regjistrua të njehsorit elektrik pasi njehsori elektrik është në emër të shitësit ku ende bëjmë pagesën në emrin e tij por kyçja është mënyrë legale e nuk është vërtet se jemi lidhur me furnizim të energjisë elektrike me një kablo jashtë njehsorit elektrik që akuzohem se i kamë shkaktuar dëm të dëmtuarës.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit I.B se nuk është kryes i veprës penale që akuzohet por deklarimi i tij ishte ikjes së përgjegjësisë penale dhe gjykata nuk e aprovoj një mbrojtje të tillë pasi një mbrojtje e tillë ishte e orientuar ikjes së përgjegjësisë penale.

Gjykata nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit përfshihen të gjitha tiparet e veprave penale vjedhja e shërbimeve nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata pasi analizoj të gjitha faktet e kësaj çështje penale, provave që gjinden në shkresat e lëndë ka aplikuar dispozitat ligjore të neneve 81, 82 të KPRK-së(Kodi Penal Nr.06/L-074 dhe ) dhe neneve 498, 499 të KPPK-së dhe të pandehurit, i ka shqiptuar sanksionin penale vërejtje gjyqësore, duke pas parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën e kryer, dhe kohen kur i pandehuri akuzohet se e ka kryer veprën penale, në rastin konkret gjykata mendon se ky sanksion penal është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Gjykata kon formë nenit 463 parag.1 lidhur me par 2.të KPPK-së, përfaqësuesin e të dëmtuarës KDS-it, Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuror-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.980/1417 me datë 11.12.2019**

**Procesmbajtëse**  
Erza Shamolli

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.